

VENDIM
Nr.328, datë 13.5.2011

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.1020, DATË 14.10.2009 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË
PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EUROPIAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të neneve 6 e 8 të ligjit nr.9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komunitetit Europian, për rregullat e bashkëpunimit të asistencës për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1020, datë 14.10.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Organizimi dhe funksionimi i agjencisë:

a) Organet drejtuese të agjencisë janë:

i) Këshilli i menaxhimit;

ii) Drejtori.

b) Këshilli i menaxhimit përbëhet nga tre anëtarë, njëri prej të cilëve zgjidhet kryetar. Ata emërohen nga Kryeministri me propozimin e zyrtarit përgjegjës akreditues, për një periudhë trevjeçare, me të drejtë riemërimi.

c) Masa e shpërblimit të kryetarit është 10 000 (dhjetë mijë) lekë, ndërsa e anëtarëve 7 000 (shtatë mijë) lekë për çdo mbledhje, por jo më shumë se një herë në muaj.

ç) Këshilli i menaxhimit ka funksione kryesore të vlerësojë, të monitorojë dhe të japë mendim për programet vjetore dhe strategjike të agjencisë, për raportimet periodike dhe vjetore, për pasqyrat financiare, për mënyrën e funksionimit të agjencisë dhe për çështje të tjera të përcaktuara nga zyrtari përgjegjës akreditues në rregulloren e funksionimit të agjencisë.

d) Mënyra e organizimit të brendshëm, autoriteti, mënyra e vendimmarrjes së strukturave të agjencisë, përfshirë këshillin e menaxhimit, si dhe çështje të tjera përcaktohen në rregulloren e funksionimit të agjencisë, e cila miratohet nga zyrtari përgjegjës akreditues, me propozim të drejtorit.”.

2. Pas pikës 10 shtohet pika 11, me këtë përmbajtje:

“11. Efektet financiare përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e shtetit për Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Europian.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha